

URDHËR
Nr. 90, datë 23.2.2021

**PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES SË PROVIMIT TË KUALIFIKIMIT PËR
PROFESIONIN E NDËRMJETËSIT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, pikave 3 dhe 5, të nenit 5/1, të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Rregullore së provimit të kualifikimit për profesionin e ndërmjetësit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjona (Saliu)

RREGULLORE
E PROVIMIT TË KUALIFIKIMIT PËR PROFESIONIN E NDËRMJETËSIT

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat e përgjithshme për provimin e kualifikimit, që kryhet nga kandidati për ndërmjetës pas përfundimit të formimit fillestar.
2. Kjo rregullore përcakton rregulla mbi mënyrën e organizimit, përgatitjen, përmbajtjen dhe vlerësimin e provimit të kualifikimit, i cili organizohet nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve dhe bazohet në procedura transparente, metoda vlerësimi të drejta dhe të besueshme dhe në një nivel të lartë të njohurive profesionale të kandidatëve.
3. Kandidatët për ndërmjetës, të cilët kanë përfunduar programin e trajnimit fillestar, si dhe që përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 5, pika 1, germa “a”, “b”, “b/1”, dhe “c”, të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar, kanë të drejtë të regjistrohen dhe të marrin pjesë në provimin për kualifikim për ndërmjetës.
4. Provimi i kualifikimit organizohet të paktën 1 (një) herë në vit nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve. Ministri i Drejtësisë përcakton me urdhër ditën, orën, vendin e zhvillimit të provimit të kualifikimit, afatet e paraqitjes së kërkesave për shprehje interesi për të hyrë në provim dhe dokumentet përkatëse që duhet të shoqërojnë kërkesën.
5. Provimi i kualifikimit përbëhet nga pjesa e kontrollit të njohurive me shkrim dhe me gojë.
6. Urdhri i ministrit të Drejtësisë, sipas pikës 4, të kësaj rregulloreje, publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, të paktën 45 (dyzetë e pesë) ditë para ditës së organizimit të provimit me shkrim.
7. Në rast se kërkohet nga personat e interesuar për të marrë pjesë në provimin e kualifikimit, nëpunësit e strukturave përgjegjëse për profesionet e lira pranë Ministrisë së Drejtësisë janë të

detyruar t'u vënë në dispozicion 1 (një) kopje të urdhrin dhe t'i sqarojnë e orientojnë lidhur me kushtet ligjore që duhen plotësuar dhe afatet përkatëse.

8. Pas publikimit të urdhrin të ministrit të Drejtësisë, që përcakton datën e organizimit të provimit, personat që dëshirojnë të marrin pjesë në provimin e kualifikimit paraqesin në Ministrinë e Drejtësisë një kërkesë për shprehje interesi, si dhe dokumentacionin përkatës që vërteton se i plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara nga legjislacioni për të marrë pjesë në provim.

9. Kërkesa e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm duhet të paraqitet jo më vonë se 21 (njëzet e një) ditë përpara ditës së organizimit të provimit.

10. Struktura përgjegjëse për profesionet e lira në Ministrinë e Drejtësisë organizon punën për regjistrimin e kërkesave dhe informon të interesuarit lidhur me kushtet e organizimit të provimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për pjesëmarrje.

11. Lista paraprake e kandidatëve të kualifikuar, për të marrë pjesë në provim, si dhe lista paraprake e kandidatëve të skualifikuar publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve jo më vonë se 14 (katërmëdhjetë) ditë para ditës së organizimit të provimit. Struktura përgjegjëse për profesionet e lira në Ministrinë e Drejtësisë i njofton çdo personi, nëpërmjet postës elektronike, shkakqet për përfshirjen në listën paraprake të kandidatëve të skualifikuar.

12. Personat, të cilët janë renditur në listën paraprake të kandidatëve të skualifikuar, për shkak se nuk plotësojnë kushtet ligjore për të marrë pjesë në provimin e kualifikimit, mund të paraqesin një ankim pranë ministrit të Drejtësisë, duke i bashkëlidhur dokumentacionin që provon përmbushjen e kriterëve ligjore, brenda 3 (tri) ditëve nga dita e publikimit të listave, sipas pikës 11, të kësaj rregulloreje.

13. Struktura përgjegjëse për profesionet e lira shqyrton ankimin e paraqitur dhe i propozon ministrit të Drejtësisë përfshirjen në listën e kandidatëve të kualifikuar, në rastet kur provohet përmbushja e kriterëve ligjore për të marrë pjesë në provim ose skualifikimin e tij nga pjesëmarrja në provim. Shqyrtimi i ankimit, si dhe marrja e vendimit nga ministri, kryhet jo më vonë se 2 (dy) ditë nga data e paraqitjes së ankimit. Ndaj urdhrin të ministrit për skualifikimin e kandidatit mund të paraqitet padë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

14. Struktura përgjegjëse për profesionet e lira përgatit edhe urdhrin e ministrit për skualifikimin e çdo kandidati, që sipas pikës 12 është renditur në listën paraprake të kandidatëve të skualifikuar dhe që nuk kanë paraqitur një ankim. Urdhri i ministrit për skualifikimin e çdo kandidati i njoftohet kandidatëve të skualifikuar, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Ndaj urdhrin të ministrit për skualifikimin e kandidatit mund të paraqitet padë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

15. Lista përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar për provim publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para ditës së organizimit të provimit.

16. Kandidatët do të paraqiten për të marrë pjesë në kontrollin e njohurive me shkrim në ditën, orën dhe vendin e caktuar në urdhrin e ministrit të Drejtësisë.

17. Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit ngrihet me urdhër të ministrit të Drejtësisë dhe përbëhet nga 2 (dy) përfaqësues të propozuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve dhe 3 (tre) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë. Komisioni është i përkohshëm dhe është përgjegjës, për:

a) hartimin e tezave të provimeve me shkrim dhe me gojë dhe përgjigjeve të tyre, duke thirrur për bashkëpunim trajnerët e trajnimit fillestar dhe vazhdues, si dhe ekspertë ose pedagogë të brendshëm

të institucioneve të arsimit të lartë, të fushave për të cilat do të testohen kandidatët. Trajneri, eksperti ose pedagogu përgatisin bankën e pyetjeve për fushën përkatëse për të cilën janë specializuar dhe përgjigjen për secilën pyetje, e cila do të shërbejë për vlerësimin e përgjigjeve të provimeve të kandidatëve për ndërmjetës. Anëtarët e Komisionit, trajnerët, ekspertët dhe pedagogët para zhvillimit të provimit nënshkruajnë deklaratë personale se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me të interesuarit e kualifikuar, që marrin pjesë në provim;

b) identifikimin e kandidatëve pjesëmarrës në provim, shpërndarjen në mënyrë rastësore të tyre në mjediset ku do të zhvillohet provimi, përzgjedhjen dhe shpërndarjen e tezave, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e provimit, përcaktimin e listës emërore të personave që morën pjesë në provim;

c) vlerësimin me pikë të përgjigjeve në provimin me shkrim dhe me gojë të dhëna nga kandidatët në raport me përgjigjet e parapërgatitura nga hartuesit e bankës së pyetjeve;

ç) shqyrtimin e ankimeve nga kandidatët ndaj rezultateve të publikuara;

d) shpalljen e rezultateve përfundimtare për kandidatët që kalojnë me sukses provimin e kualifikimit dhe renditjen e tyre në përputhje me rezultatet e provimit të kualifikimit;

dh) mbajtjen dhe evidentimin e gjithë dokumentacionit që lidhet me provimin e kualifikimit.

18. Hyrja për në mjediset e brendshme të zhvillimit të provimit me shkrim do të bëhet 1 (një) orë përpara orarit të njoftuar për provimin.

19. Identifikimi i kandidatëve bëhet në bazë të një dokumenti identifikimi personal të vlefshëm dhe me fotografi, i cili mund të jetë letërnjoftim ose pasaportë.

20. Kandidatët, që nuk kanë mjet identifikimi të vlefshëm, përjashtohen nga pjesëmarrja në provimin me shkrim.

21. Kandidatët ftohen të zënë vendet sipas një përzgjedhjeje rastësore të caktuar nga anëtarët e Komisionit dhe, për asnjë arsye, nuk mund të ndryshojnë vendin e caktuar. Kandidati nuk lejohet të dalë jashtë, si dhe asnjë person i paautorizuar nuk lejohet të futet në sallën e provimit, përfshirë këtu edhe kandidatët të cilët janë paraqitur jashtë afatit të përcaktuar për hyrjen në sallë.

22. Pasi është kryer identifikimi i kandidatëve, udhëzohen të deklarojnë nëse janë apo jo të pajisur me mjete të tilla, si: çantë, dosje, laps ose stilolaps, mjete elektronike ose telefonike, të cilat nuk lejohen në sallën e provimit. Nëse kandidatët janë të pajisur me mjete të tilla, duhet t'i dorëzojnë për ruajtje të gjitha këto sende pranë punonjësve të caktuar për këtë qëllim.

23. Kandidatëve u shpërndahen baza materiale e nevojshme për kryerjen e provimit dhe kopje të parapërgatitura të testit, të cilat kanë në çdo fletë nënshkrimin e kryetarit të Komisionit Mbikëqyrjes dhe Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve dhe kodin e provimit. Kodi i provimit do të jetë një numër me dy ose më tepër shifra dhe unik për çdo kopje të testit dhe për çdo kandidat, i cili do të përdoret gjatë gjithë procesit të zhvillimit të provimit të kualifikimit.

24. Pas shpërndarjes së testit, kandidatëve u kalohet një listë me emrat e tyre dhe secili shënon kodin e testit përbri emrit të vet. Pas përfundimit të shënimit të kodeve nga të gjithë konkurrentët, lista mbyllet në një zarf të veçantë, për t'u hapur nga Komisionit i Mbikëqyrjes dhe Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve pas mbarimit të procesit të vlerësimeve të përgjigjeve për të gjitha testet.

25. Përpara fillimit të provimit, kandidatët vihen në dijeni, për:

a) kohën brenda së cilës duhet të përfundojnë dhënien e përgjigjeve, e cila gjendet e përcaktuar në tezën e provimit;

b) udhëzohen që të mos komunikojnë mes tyre ose me persona jashtë mjedisit ku organizohet provimi;

c) udhëzohen të mos shënojnë ose lënë emrin, të bëjnë shenja sado të vogla, shprehje apo citime në tezën e provimit, të cilat mund ta bëjnë aplikantin të identifikueshëm;

ç) të mbajnë qetësi;

d) të mos konsultohen me libra ose materiale të tjera të shkruara;

dh) mënyrën e komunikimit me anëtarët e Komisionit, në rast nevojë, e cila duhet të jetë me zë të ulët dhe duke e thirrur në vendin e zhvillimit të provimit;

e) përzgjedhjen e zarfit të tezës me zgjedhje rastësore përpara auditorit;

ë) u jepen udhëzime e sqarime të tjera të rastit, e vihen në dijeni për pasojat, në rast se nuk i respektojnë kërkesat e parashtruara.

Pas njoftimit mbi rregullat e provimit, konkurrenti ftohet të plotësojë një deklaratë me shkrim, se u njoh me rregullat dhe i pranon ato, si dhe se është i ndërgjegjshëm se shkelja e tyre përbën shkak për skualifikimin e menjëhershëm nga provimi. Refuzimi për nënshkrimin e deklaramentit, apo kundërshtimi i përmbajtjes së tij, sjell humbjen e menjëhershme të së drejtës për të kryer provimin.

26. Pyetjet e provimit do t'i referohen legjislacionit që zbatohet në ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit, duke synuar testimin e njohurive dhe të aftësive të kandidatit në fushat e veprimtarisë së ndërmjetësit dhe zgjidhjen e rasteve konkrete.

27. Provimi i kualifikimit mbulon të gjitha lëndët e zhvilluara sipas programit të formimit fillestar të detyrueshëm, të cilit i nënshtrohet kandidati.

28. Provimi përbëhet nga pjesa teorike dhe nga pjesa praktike mbi temat e trajtuara në trajnimin fillestar në fushën civile, tregtare, të punës dhe familjare, pronësisë intelektuale, të drejtave të konsumatorëve, të mosmarrëveshjeve midis organeve të administratës publike dhe subjekteve private, të drejtave me karakter pasuror, si të drejtat e pronësisë ose të bashkëpronësisë, pjesëtimin e pasurisë, paditë për kërkimin e sendit, për paditë mohuese e për paditë për pushimin e cenimit të posedimit, mosmarrëveshjet që rrjedhin nga mospërmbushjet e detyrimeve kontraktuese, ato që kanë si objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktues dhe fushës së të drejtës penale, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 2, të ligjit, si dhe nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.

29. Tezat e provimit me shkrim dhe pyetjet e provimit me gojë përgatiten nga Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve jo më herët se 1 (një) ditë para datës së organizimit dhe nuk duhet t'u bëhen të ditura personave të tjerë. Pyetjet e provimit me shkrim hartohen në disa teste të ndryshme, të cilat futen në zarfe të ndryshme, prej të cilëve një do të zgjidhet për t'u aplikuar në provim. Të gjitha zarfet duhet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve.

30. Zgjedhja e zarfit do të bëhet me short, ditën që do të organizohet provimi dhe në prani të kandidatëve. Zarfi duhet të jetë i mbyllur dhe i nënshkruar, në të kundërtën, teza në të është e pavlefshme dhe zëvendësohet me një zarf tjetër të mbyllur. Pas përzgjedhjes, zarfi hapet nga Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve dhe teza e përzgjedhur u bëhet e ditur publikisht kandidatëve nga kryetari i Komisionit. Në një zarf tjetër të mbyllur, ndodhen brenda përgjigjet e testit në 2 (dy) kopje dhe hapet kur të përfundojë koha e provimit.

31. Teza e provimit përmban pyetje me alternativa. Për plotësimin e saj, kandidati rrethon saktë vetëm njërin prej tyre. Korrigjimi i mëvonshëm apo shënimi i më shumë se një alternative për secilën pyetje e bën përgjigjen automatikisht të pasaktë. Fletët e përgjigjes së testimit do të jenë të gjitha të vulosura në pjesën e pasme.

32. Teza e provimit korrigjohet nëpërmjet sistemeve elektronike, që garantojnë vlerësimin automatik të përgjigjeve.

33. Gjatë plotësimit të tezës së provimit nuk lejohen nënvizime apo shenja të tjera, si edhe nuk duhet të përdoren baza të tjera materiale, veç atyre të vëna në dispozicion sipas pikës 23, të kësaj rregulloreje.

34. Kandidati, që gjatë provimit nuk i respekton udhëzimet e dhëna sipas kësaj rregulloreje, njoftohet pa paralajmërim të ndërpresë provimin dhe të lërë menjëherë sallën e provimit, duke i komunikuar edhe skualifikimin nga procedura e provimit.

35. Kandidati i skualifikuar, sipas pikës 34, të kësaj rregulloreje, barazohet me kandidatët që nuk e kanë marrë minimumin e nevojshëm të pikëve për t'u kualifikuar. Në këtë rast, përkrah emrit të personit bëhet shënimi "Skualifikohet", vihet në dijeni kryetari i Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve dhe bëhet pasqyrimi përkatës në procesverbalin e provimit, ku shënohet nxjerrja jashtë procesit të vlerësimit të tezës së kandidatit të skualifikuar, si dhe shkaqet që kanë çuar në skualifikimin e kandidatit.

36. Procesverbali i provimit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve dhe bëhet pjesë e dosjes mbi procedurat e zhvilluara duke i bashkëlidhur edhe tezat e kandidatëve të skualifikuar.

37. Pas përfundimit të kohës së caktuar për provimin, bëhet mbledhja e përgjigjeve të tezave të kandidatëve, si dhe të gjitha materialet e tjera të përdorura në provim dhe, nëse është rasti, bëhen shënimet përkatëse sipas parashikimeve të mësipërme.

38. Pasi janë dorëzuar testet për vlerësim automatik, hapet zarfi me përgjigjet e testit dhe 1 (një) kopje e përgjigjeve administrohet nga Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve, ndërsa 1 (një) kopje tjetër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

39. Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve administron rezultatet e dala nga vlerësimi automatik i tezave dhe përlogarit shumën e pikëve të fituara nga kontrolli i njohurive me shkrim për çdo tezë provimi. Administrimi i rezultateve të përfituara nga korrigjimi automatik dokumentohet me procesverbal nga një prej anëtarëve të Komisionit, që zgjidhet nga kryetari. Anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve në mbledhje.

40. Vlerësimi i provimit të kualifikimit bëhet me maksimumin e mundshëm 100 (njëqind) pikë, nga të cilat kontrolli i njohurive me shkrim përbën 75% të numrit të përgjithshëm të pikëve (75 pikë) dhe kontrolli i njohurive me gojë përbën 25% të numrit total të pikëve (25 pikë).

41. Testet e vlerësuar automatikisht nënshkruhen në çdo fletë nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve. Rezultatet e përgjigjeve të përfituara nga sistemi elektronik i vlerësimit për çdo test pasqyrohen në një listë, e cila përmban kodin dhe përbri pikët vlerësuese. Lista nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Pas nënshkrimit të listës me kodet dhe pikët e vlerësimit për testet përkatëse, hapet zarfi me emrat dhe kodet e kandidatëve dhe përbri emrit dhe kodit të çdo kandidati shënohen pikët e fituara.

42. Lista me emrat, kodet dhe pikët e fituara nga kandidatët nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve. Një kopje e saj, e cila përmban vetëm kodet dhe pikët e fituara nga kandidatët, publikohet brenda ditës në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve. Për efekt ankimi, publikimi është i barasvlershëm me njoftimin e çdo kandidati.

43. Kandidatët, që kanë vërejtje për vlerësimin, kanë të drejtë të ankohen brenda 3 (tri) ditëve nga dita e afishimit të listës. Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve shqyrton ankimet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas kalimit të këtij afati dhe vë në dijeni ankuesin mbi shqyrtimin e ankimit.

44. Kandidati që vlerësohet me të paktën 55 (pesëdhjetë e pesë) pikë në provimin me shkrim kalon në kontrollin e njohurive me gojë.

45. Provimi me gojë, i cili është i hapur për publikun, zhvillohet jo më vonë se 2 (dy) javë pas provimit me shkrim përpara Komisionit të provimit. Provimi me gojë regjistrohet nëpërmjet mjeteve audio ose audiovizive, përveç rasteve kur kandidatët shprehimisht kërkojnë që provimi me gojë të mos jetë i regjistruar.

46. Menjëherë pas përfundimit të provimit me gojë, anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit për Ndërmjetës japin vlerësimin e tyre në lidhje me rezultatet e secilit kandidat, në mbledhje me dyer të mbyllura, duke përllogaritur shumën e pikëve të përgjithshme të fituara nga kontrolli i njohurive me shkrim dhe me gojë. Anëtarët e Komisionit votojnë për vlerësimin me pikë. Anëtarët e Komisionit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve dhe të votimit në mbledhje.

47. Lista me emrat, kodet dhe pikët e fituara për secilin kandidat nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe i bashkëlidhet procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve.

48. Kandidati që ka kaluar provimin me shkrim dhe me gojë dhe që vlerësohet në total me pikët më të larta në renditje, por jo më pak se 80% të pikëve, konsiderohet fitues. Kandidatët që kalojnë me sukses provimin e kualifikimit, renditen në përputhje me rezultatet e provimit të kualifikimit. Lista me kodet dhe pikët e fituara për secilin kandidat publikohet në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

49. Për marrjen e vendimit për përllogaritjen e pikëve të përgjithshme për çdo kandidat, mbahet procesverbal nga një prej anëtarëve të Komisionit, që zgjidhet nga kryetari. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve, përfshirë edhe ata që nuk pajtohen me vendimin. Anëtari, që nuk pajtohet me qëndrimin e shumicës, e nënshkruan procesverbalin me shënimin “Nuk pajtohem me vendimin. Bashkëlidhur paraqes mendimin tim”. Anëtari në pakicë paraqet veçmas, me shkrim, mendimin e tij dhe pasi nënshkruhet nga hartuesi, i bashkëlidhet procesverbalit. Në rast se anëtari i Komisionit, i cili ka mendim të kundërt me shumicën, nuk përkatit mendimin e tij me shkrim si më lart, kundërshtimi i tij konsiderohet i paqenë.

50. Kandidatët që kanë vërejtje për vlerësimin e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe të Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve, që kanë kërkuar regjistrimin me mjete elektronike të provimit me gojë, kanë të drejtën e ankimit brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni për rezultatet e provimit.

51. Pas shqyrtimit të ankimeve dhe njoftimit të kandidatëve që kanë paraqitur ankimet, Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve përkatit listën me emrat, kodet dhe pikët e fituara për secilin kandidat, e cila nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij. Lista i bashkëlidhet procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Mbikëqyrjes dhe i Vlerësimit të Provimit të Ndërmjetësve. Një kopje e listës përfundimtare me kodet dhe me pikët e fituara për secilin kandidat publikohet në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

52. Procesverbalet, përgjigjet e tezës të dhëna nga kandidatët, tezat e skualifikuara, si dhe gjithë dokumentacioni tjetër që krijohet dhe i përket procesit të organizimit të provimit, shpalljes së rezultateve dhe të kandidatëve që kalojnë me sukses provimin, ruhen në arkivin e Ministrisë së Drejtësisë, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.

53. Kandidatët që kalojnë me sukses provimin e kualifikimit kanë të drejtë të paraqesin dokumentacionin për pajisjen me licencën e ndërmjetësit pranë ministrit të Drejtësisë dhe të regjistrohen në Regjistrin e Ndërmjetësve pranë Ministrisë së Drejtësisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar.